



V-9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, E-cbiste: ccc.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	14613 2018
---------------------------------	---------------

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PERIODIK / VJETOR

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Emri	Atësia	Mbiemri
Ervin	Bujar	Salianji
Funksioni		
Deputet		
Institucioni dhe adresa		
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë		
Data e emërimit në funksionin që kryen	Data e dorëzimit të deklaratës	
09.09.2017	11.03.2019	

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.


Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1	Paga dhe përfitime financiare nga Kuvendi	2,287,733 Lek Dy milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre	
2	Përfitim nga interesi i depozitës në Euro në [redacted]	170 Euro Njëqind e shtatëdhjetë Euro	
3	Përfitim nga interesi i depozitës në lek në [redacted]	14.000 lek Katërmëdhjetë mijë lek	
4	Shtesë depozite për kartën e kreditit në [redacted] marrë nga llogaria rrjedhëse në Euro në [redacted]	1000 Euro Një mijë Euro	

* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

Ervin Salianji



Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET
NË VEPRIMTARI
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

Enxhin Saliaj



Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.


Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

Enxhin Salimaj



Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit

Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

Deklarimi i interesave private nga zyrtari (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private priodik/vjetor” duhet të plotësohet nga zyrtari në funksion, por **edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më pak se një vit nga funksioni i mëparshëm** (nga deklarimi i tij i fundit).
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter). Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, deri më 31 Mars të çdo viti.

Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin (subjektin deklarues)

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshortit/ja, bashkëjetuesit/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, **për pasuritë që disponojnë veçmas.**
- Subjekti/Personi i lidhur me zyrtarin, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore), i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, subjekti deklarues personi i lidhur, është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës “AUTORIZIMI” ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.